



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:064430

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06352075

C.nr.1154/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit K. (Q) B. me numër personal nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, tani me vendbanim në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.G. nga Prizreni, kundër të paditurit F.S. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson M.G. nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimi i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 50,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor – publik, me datën 17.10.2024, në të cilën prezantuat të autorizuarit e ndërgjyqësve, ndërsa më datë 25.10.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M
(Në bazë të pohimit)

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit K. (Q) B. nga Prizreni, dhe **VËRTETOHET** se i njëjti në bazë të parashkrimit fitues është pronar i ngastrës kadastrale me nr. P-71813068-..... e cila gjendet në vendin e quajtur “Ortakol”, në sipërfaqe prej 288 m², ZK Prizren, si dhe detyrohet i paditurit F.S. nga Prizreni, ta pranojë këtë dhe të lejojë regjistrimin në librat kadastral, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi K.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. E.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurit F.S. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë. I njëjti në padi kishte theksuar se që nga viti 1983 është posedues faktik i ngastrës kadastrale me nr.5632/-1, 540, 499 në Zonën Kadastrale në Prizren, në sipërfaqe prej 293 m² me 1/1 pjesë ideale të pronës. I njëjti këtë parcelë e kishte blerë më datën 02.11.1983 nga i padituri F.S. ku ka qenë e ndërtuar edhe shtëpia një katesh në gabarit, në shumën e përgjithshme prej DM, e cila evidentohet në emër të F.S. më tutje thekson se të njëjtën e shfrytëzon mbi 30 vite pandërprere dhe të penguar nga askush, mirëpo për shkaqe objektive pasi që në kohën e luftës tatimet ka qenë shumën të mëdha dhe nuk ka mundur të bart në emër të tij këtë palujtshmëri, po ashtu i njëjti ka interes juridik që këtë palujtshmëri të regjistroj në emër të tij.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari paditësi ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve të padisë ndërsa pas administrimit të provave e në veçanti ekspertizës së gjeodezisë ka bërë precizimin kërkesëpadisë ashtu që ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi K.B. është pronar i ngastrës kadastrale P-71813068-....ZK Prizren, në sipërfaqe prej 288 m² në vendin e quajtur “Ortakoll” në pjesën e pronës 1/1 në bazë të parashkrimit fitues. Shpenzimet procedurale nuk i kërkon.

Për gjatë shqyrtimit kryesor e autorizuar të paditurit nuk e konteston kërkesëpadinë, përkatësisht e pranon kërkesëpadinë me të cilën është kërkuar të vërtetohet se paditësi është pronar i paluajtshmërisë në njësinë kadastrale P-71813068-..... e cila gjendet në vendin e quajtur “Ortakoll”, në sipërfaqe prej 288 m², ZK Prizren, dhe që kjo paluejtshmëri të regjistrohet në emër të paditësit, pasi që e njëjta paluajtshmëri është blerë para 30 vitesh, po ashtu pagesat janë kryer dhe se paditësit e ka në posedim dhe shfrytëzim të pa ndërprerë dhe të pa penguar nga askush. Shpenzimet procedurale nuk i kërkoj.

Gjykata, për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, ka administruar këto prova: kontratën e shitblerjes së paluajtshmërisë, të datës 01.11.1983; raportin e ekspertit të gjeodezisë F. (H) R. të datës 05.03.2024; certifikatën e pronësisë në origjinale, me nr.07-029-9774-24, të datës 24.10.2024, për ngastrën kadastrale 05632-14 ZK Prizren, si dhe raporti neuropsikiatrik për të paditurin F.S. të lëshuar nga ordianca specialistike për neurologji dhe psikiatri Dr. Raim Krasniqi.

Pas marrjes së raportit të ekspertit të gjeodezisë në të cilin palët nuk kanë pasur vërejtje, gjykata ka konstatuar se parcela kadastrale me numër 05632-14, Zona Kadastrale në Prizren, në sipërfaqe prej 288 m² evidentohet në emër të F.S. pjesa e pronës 1/1, në parcele është e ndërtuar objekti i banimit me etazhitet P+1, ekspertit të gjeodezisë F. (H) R. në shqyrtimin kryesor të mbajtur më datë 17.10.2024 ka deklaruar se ngastra kadastrale me nr. të njësisë KK Prizren është e njëjta ngastër kadastrale e cila tani evidentohet me nr.5632-14 ZK Prizren deri tek këto ndryshime ka ardhur si pasojë e ndarjeve fizike të ndodhura ndër vite. Nga leximi i kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë, të datës 01.11.1983, gjykata ka konstatuar faktin e shitblerjes së kësaj paluajtshmëri e lidhur në mes F.S. në cilësinë e shitësit dhe K.B. në cilësinë e blerësit. Nga leximi i Certifikatës për njësinë kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren të datës 24.10.2024 gjykata ka konstatuar se njësia kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren, evidentohet në emër të F.S. Nga raporti neuropsikiatrik për të paditurin F.S. të lëshuar nga ordianca specialistike për neurologji dhe psikiatri Dr. R.K. gjykata ka konstatuar se i njëjti është i vetëdijshëm dhe i llogaritshëm për veprimet dhe sjelljet e veta. Andaj, pasi që i padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit dhe se e ka pranuar në tërësi të njëjtën duke pohuar faktin se paditësi mbi 30 vite ka në posedim të pandërprerë ngastrën e cila është objekt kontesti dhe se deri në posedim ka ardhur me mirëbesimi, gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Në lidhje me vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi konform nenit 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 28 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore dhe nenit 148 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr. 1154/2022 të datës 25.10.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin eventual të dhunës apo mashtrimi.